

30.03.2021  
Ora 18:39

**RENDI I DITËS**

**Diskutime në lidhje me fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y.Merkaj, M. Koja, N. Mezini
- Parti Politike: PD, LSI, LN, Nisma Thurje, PS

**Znj.I.Nano:** Mirëmbërëma, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 17:30. Kërkojmë ndjesë për vonesën në çeljen e mbledhjes për arsye të mungesës objektive në sallë të një prej anëtarëve.. për shkakë objektive të një prej anëtarëve të Komisionit. Derisa teknikisht mundësua që zoti Çaka të jetë në linjë i pranishëm në mbledhje. Katër anëtarë të tjerë të Komisionit janë të pranishëm në sallë, kështu që pjesëmarrja e Komisionit Rregullator është e plot. Në këtë mënyrë mund ta çelim mbledhjen, e deklaroj mbledhjen të hapur. Siç është njoftuar më herët në mbledhje kemi për të shqyrtuar 12 (dymbëdhjetë) projektvendime, kanë ardhur si propozim i Komisionerit, për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore dhe fillojnë 12 (dymbëdhjetë) zonat zgjedhore nga Berati deri në Vlorë

1

Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill”. Pra, janë 12 (dymbëdhjetë) projektvendime nëse dëshironi mund t’i lexoj të gjitha me rradhë:


1. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
2. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Dibër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
3. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
4. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
5. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
6. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
7. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Korçë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
8. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Kukës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
9. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
10. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
11. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
12. “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Më lejoni të verifikoj edhe njëherë nëse janë të 12 (dymbëdhjetë) qarqet. Dakord janë të gjitha. Janë njohur me projektvendimin anëtarët e Komisionit Rregullator,

2

*Zbardhi materialin audio*

*Jônida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, mediat. Në përmbajtje të gjitha projektvendimet janë të njëjta si në bazën ligjore dhe në përmbajtjen e aktit bashkëlidhur. Ndryshimet kanë të bëjnë me listat shumëëmërorë të cilat janë paraqitur në tre variante të tre formateve të ndryshme të fletës së votimit. Atëherë, fillojmë diskutimin.

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Për procedurë?

**Znj.I.Nano:** Po zoti Salianji.


**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** U njohëm me rendin e ditës si nga Ju si edhe nga email-i që na ka ardhur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Znj.I.Nano:** Kërkoj ndjesë zoti Salianji nuk pret kërkesa jua për të komunikuar me Komisionerin, pra për të paraqitur projektaktin apo është paraprakisht kjo procedurë?

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Ne po them jemi njohur me aktin prandaj nëse do të bëhet një relativ sepse nuk ka kuptim diskutimi për procedurë.

**Znj.I.Nano:** Dakord.

**Z.M.Çakaj:** Po, por referuar rregullores së Komisionit Rregullator paraprakisht përpara se të.. përtej faktit që është dërguar me email përpara se ju të merrni të drejtën e fjalës do të duhet që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të prezantojë aktin dhe më pas në momentin përkatës kur të keni ju të drejtën atëherë mund të diskutoni. Sigurisht me të drejtën tuaj.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Znj.H.Vukaj:** Publiku nuk e di se cili është akti vetëm e dëgjoi t'i nominohet titulli kështu që meriton sipas rregullores që t'i bëhet prezantimi i aktit.

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Tani meqenëse janë 12 (dymbëdhjetë) akte dhe u bë një prezantim nga moderatoria, nga Kryetaria unë e quajta këtë sikur ne filluam shqyrtimet administrative, por në qoftë se ju e keni këtë rregull dakord. Unë tërhiqem dhe do të flas mbas fjalës së Komisionerit. Por, fjala është për procedurë pa diskutuar themelin e aktit. Rezervoj të drejtën.

**Znj.I.Nano:** Zonja Vukaj, po.

**Znj.H.Vukaj:** Zonja Nano sapo bëri prezantimin dhe ndërkohë bazuar në rregullore i takon zotit Celibashi që të bëjë prezantimin si propozues i aktit. Pra, nëse zonja Nano apo secili nga ne do të ishte propozues i mëvetëm i aktit apo i pavarur atëherë po, kjo mund të vlente. Pra, mund ta merrnim në konsideratë leximin e titujve nga zonja Nano në këtë rast propozuesi është zoti Celibashi. Kështu që i takon të vijojë prezantimin e aktit për ne, për ju dhe për publikun, faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Atëherë, për procedurë para se të fillojmë shqyrtimin e 12 (dymbëdhjetë) akteve jashtë rendi të ditës ka diskutime? Dakord, faleminderit. Komisioner ju lutem një prezantim të projektaktit pastaj zoti Salianji për procedurë.


**Z.I.Celibashi:** Po, faleminderit zonja Kryetare. Atëherë, projektakti i cili.. në fakt janë 12 (dymbëdhjetë) projektakte kanë për qëllim miratimin e përmbajtjes në mënyrë përfundimtare të fletës së votimit për zgjedhjet e 25 Prill-it të viti 2021. Janë 12 (dymbëdhjetë) projektvendime të cilët i korrespondojnë 12

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

(dymbëdhjetë) zonave zgjedhore dhe 12 (dymbëdhjetë) qarqeve. Për faktin se numri i kandidatëve në listën shumëemrore, numri mandateve në çdo qark është i ndryshëm kemi vlerësuar që të jetë vendimmarrje e vençat për secilin prej qarqeve për sa i përket përmbajtjes së fletëve së votimit. Në fakt në propozimin e Komisionerit, në propozimin tim si Komisioner kjo vlen për të gjitha projektaktet. Nuk kam paraqitur një propozim konkret në lidhje me atë se si duhet të jetë përmbajtja e fletës së votimit për secilin prej qarqeve i kam propozuar Komisionit Rregullator tre variante sipas të cilit pastaj është në zgjedhjen tuaj mundet të jetë përmbajtja e fletës së votimit. Në dy prej këtyre varianteve përmbajtja e fletës së votimit reflekton të ketë përmbajtje edhe emrat e kandidatëve (emër, mbiemër) të çdo subjekti zgjedhor dhe në një variant të tretë përmbajtja e fletës së votimit është pa emrat e kandidatëve. Por, janë emrat e kandidatëve ose janë të përcaktuar me numrat e tyre të renditjes në listën shumëemrore të paraqitur nga subjektet zgjedhor. Në fund të fundit si në njërin variant por edhe në variantin tjetër mendoj që secili prej tyre reflekton përcaktimet e ligjit, e Kodit Zgjedhor mbi përmbajtjen e fletës së votimit dhe zgjedhja pastaj varet duke marrë në konsideratë edhe rrethana dhe faktorë të tjerë. Nëse ju e çmoni dhe vlerësoni që formalisht edhe nga ana e Komisionerit do të duhet të ishte qoftë edhe në formën e një propozimi të formalizuar, përcaktuar se cili prej varianteve është, unë këtë mund ta bëj. Më thoni, faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit, Komisioner. Zoti Salianji?

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Po, faleminderit. Për sa i përket procedurës dhe të drejtës që ka Komisioni Rregullator në shqyrtimin e projektaktit unë e çmoj me vend dhe duke u referuar dhe baza ligjore që ka venë vetë Komisioneri për sa i përket këtij projektakti është neni 20 pika 1 shkronja "a" e Kodit Zgjedhor ku përcaktohen kompetenca e Rregullatorit. Unë nuk e gjej në këtë dispozitë një




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

kompetencë nga ana juaj për të vendosur në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit. Kjo kompetencë për mendimin tonë dhe sipas Kodit Zgjedhor është një kompetencë që i takon Kryekomisionerit dhe ai mundet që në vendimmarrjen e tij siç merr vendimet që ka kompetencë mund të marrë dhe këtë vendim. Për arsye se neni 20 pika "a" thotë "Rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore, procedura që zbatohen në zgjedhje". Pra, kjo dispozitë nuk ua jep ju të drejtën për të diskutuar në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit. Pra, në kompetencë kjo është e KQZ-së, por jo e Komisionit Rregullator, por e Komisionerit. Unë doja që këtu të pushonte shqyrtimi administrativ dhe ju këtë akt t'ia kaloni Komisionerit për shqyrtim, ose Komisioneri mund ta tërhiqte aktin dhe ta shqyrtonte vetë. Baza ligjore vendosur në projektakt nuk i përgjigjet asaj ç'ka ju keni. Detyra e përcaktuar konkretisht për sa i përket akteve, faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit, zoti Salianji. Zonja Vukaj doni fjalën? Po, zonja Vukaj.

**Znj.H.Vukaj:** Atëherë, më në fund erdhëm dhe tek.. le të themi tek akti më i rëndësishëm përmes të cilit shqiptarët presin të shprehin përfundimisht, qartësisht dhe ashtu siç ligji pra, Kushtetuta e njeh të drejtën për të votuar. Pra, tek akti i miratimit të fletës së votimit. Një akt i cili është në kompetencën e Komisionit Rregullator si akt normativ për ta miratuar vjen në vijim të një akti pararendës ku ne miratuam elementë dhe përcaktuam deri diku standardin e fletës së votimit. Por, në kuadrin kur propozuesi në këtë rast zoti Komisioner, zoti Celibashi na ka paraqitur tre variantet e mundshme ose të menduara prej tij, unë kam paqartësinë e ndarjes që duhet t'i bëjmë rregullshmërisht në momentin kur propozuesi në këtë rast, zoti Celibashi duhet të na paraqesë një akt. Akti paraqitet një dhe i vetëm dhe në këtë kuadër kjo prurje në tre versione ne na fut sërish në dilemën e




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

paqartësisë se cili është propozimi përfundimtar i Komisionerit. Ndaj dhe në këtë kuadër, unë mendoj që zotit Celibashi ose duhet t'i lemë kohë që të zgjedhë se cili është versioni i tij përfundimtar, që ne më pas të çelim diskutimin për versionin përfundimtar dhe t'i japim vullnetin tonë apo jo këtij versioni, faleminderit. Edhe diçka tjetër nuk mund ta lë pa përmendur dhe e përsëritës zotin Komisioner me rastin e paraqitjes dhe hedhjes në rrjetet sociale apo në facebook të fletës së votimit. Si fletë e parapëlqyer të disa versioneve dhe me sa dokumentohet shqiptarët apo shtetasit me të drejtë vote kanë përzgjedhur fletën e cila i duket vizualisht më e pranueshme dhe këto rezultate janë në faqen e KQZ-së. Kështu që mund të jetë një orientim i shkëlqyer për të vijuar ne më tej punën ose për t'u orientuar drejt fletës më të përshtatshme që është zgjedhur nga 79% e votave, faleminderit.

*(ndërhyrja nuk dëgjohet)*

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zonja Vukaj. Zoti Salianji po, por do të duhet edhe përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore të shprehen për këtë kërkesë procedurale për faktin që është kaq i rëndësishëm.

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Prandaj.. vura re se këtu hytë për diskutimin e thelbit edhe prandaj po e bëj këtë ndërhyrje pra, një kërkesë për procedurë. Këtu po diskutojmë keni apo nuk keni kompetencë, pastaj sa i përket thelbit të fletës dhe se si janë shprehur qytetarët për këtë fletë ose për kë fletë do të votojë, kjo është nëse ju do të vendosni ta shqyrtoni përmbajtjen e fletës së votimit. Unë siç ua përsërita në nenin 20 në të gjithë paragrafët e tij jo vetëm në pikën "a" ku thuhet "Rregulla, rregulla, rregulla.." ju bëni vetëm rregulla, akte normative. Fleta e votimit nuk është akt normativ, nuk bëni rregulla ju dhe kërkoj që ju të shpreheni njëherë për procedurën do ta shqyrtoni apo jo, pastaj nëse do t'i hyjmë debatit se



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

cila fletë? Ai është një debat tjetër që do të shqyrtohet mbasi të vendosni në lidhje me shqyrtimin ose mos shqyrtimin e aktit të Komisionerit, faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Zoti Kaso?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zonja Kryetare. Nuk doja të ndërhyja sepse mendoja që Komisioni Rregullator do ta zgjidhte vetë siç ka për të zgjidhur edhe çështjen e kërkesave paraprake lidhur me këtë mbledhje dhe me këtë akt. Besoj se është e kundërta e asaj që tha kolegu im i Partisë Socialiste. Kërkesën për procedurë që bëri, e cila përmbante në vetvehte dhe kërkesën për pushimin e shqyrtimit nga ana juaj. Kjo është e lidhur ngushtësisht me shqyrtimin në themel të aktit.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Ndërkohë në qoftë se e kuptova si duhet kërkesën e zonjës Vukaj, kërkesa ishte për Komisionerin i cili me një propozim të vetin ka vënë në lëvizje Komisionin Rregullator, i cili nuk është vënë në lëvizje vetvetiu, por në bazë të kërkesës së Komisionerit të saktësonte përmbajtjen e aktit që shtronte për diskutim dhe eventualisht për miratim nga ana juaj. Në qoftë se nuk e kam kuptuar gabim zonja Vukaj thotë, se akti përmban në vetvete tre lloj aktesh. Përpara se ju të shikoni titullin e aktit, brendësinë e aktit, bazën ligjore të aktit siç tha kolegu i Partisë Socialiste besoj që duke qenë se nuk është akti juaj është detyrimi juaj që t'ia ktheni Komisionerit për saktësim akti që në radhë të parë të sqarojë natyrën e vet. Pastaj lind e drejta juaj dhe e jona bashkë me ju që të diskutojmë lidhur me natyrën e aktit është akt që përmban rregulla. A është akt që detajon përmbajtje, por kjo përmbajtje është apo jo pastaj në kompetencën tuaj. Të gjitha këto janë të lidhura ngushtësisht me aktin që duhet të shqyrtoni që të keni në tryezë. Para se ta shqyrtoni duhet të keni një akt të saktë dhe të qartë në tryezën tuaj të diskutimit, faleminderit.

**Znj. I. Nano:** Zoti Kaziaj meqënëse folën me radhë, kishit ju diçka? Po zoti Çakaj?

**Z. M. Çakaj:** Atëherë sërish referuar Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Komisionit Rregullator nenin 14 "Përmbajtja e dosjeve materialeve për mbledhjen e Rregullatorit". Në pikën 1 dhe në pikën 2, parashikohet se çfarë përmban dosja e materialeve për mbledhjen që shqyrtohet në mbledhjen e Rregullatorit. Në relacionin tuaj e nderuar, si dhe në relatimin që bëri Komisioneri dhe stafi Administrata e KQZ-së, unë referuar nenit 14 të Rregullores, pika 1 germa "d", nuk shikoj të kemi ndonjë material ku parashikojmë propozime për ndryshime apo shtesa nga subjekte zgjedhore sipas

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

nenit 15. Pra, i bie që paraprakisht përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia Socialiste, është njohur me materialin dhe sigurisht që është një synim i të gjithëve të paktën deri në mbledhjen e tanishme nuk ka pasur asnjë pretendim. Kjo ishte për procedurë, përtej kësaj sigurisht që shkurtimisht vetëm neni 20 pa hyrë fare pretendimeve që ngriti përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia Socialiste. Në nenin 20, pika 1, germa "a", të Kodit Zgjedhor parashikohet që Komisioni Rregullator ka të drejtë të shqyrtojë dhe të miratojë projektaktet me karakter normativ dhe pika "a", parashikon rregullat e detajuara për organizimet administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje. Besoj se kjo është ezauruse meqë nuk e gjente dot bazën ligjore. Nga ana tjetër më lejoni dhe mua të vlerësoj së pari punën e bërë nga Komisioneri Shtetëror. Së dyti sigurisht edhe unë i bashkohem mendimit të koleges Vukaj, lidhur me saktësimin e një modeli konkret të fletës në mënyrë që ne si anëtarë të Rregullatorit ta shqyrtojmë ose ta miratojmë, ose nëse nuk biem dakord ta kundërshtojmë propozimin e bërë nga Komisioneri. Kështu që edhe unë kërkoj nga Komisioneri ndoshta ka nevojë për më shumë kohë të saktësojë variantin konkret që ai e gjykon dhe vlerëson për t'i prezantuar Komisionit Rregullator, i cili përmbush të gjithë pritshmëritë e Kodit Zgjedhor. Mos ta harrojmë se në ndryshime të Kodit Zgjedhor kemi dy ndryshime 23 Korrik dhe në 5 Tetor ka një nocion të ri, pra është futur votimi parapëlqyes. Në nenin 98, pika 1 dhe pika 4 parashikohet sesi duhet të kompozohet fleta e votimit. Neni 106, pika 1 parashikon dhe orienton të gjithë zgjedhësit për mënyrën sesi duhet të votojmë po ashtu e njëjta procedurë dhe në rastin e numërimit apo vlefshmërisë së fletëve të votimit parashikojnë në nenin 117. Nga ana tjetër kemi dhe nenin 67 të Kodit Zgjedhor, që në krye të herës kur subjektet zgjedhore paraqesin listat shumemërore të kandidatëve të cilët sigurisht paraqitet siç e parashikon qartë Kodi neni 67, pika 4 me numër rendor dhe emrat e kandidatëve. Megjithatë nuk po zgjatem shumë meqë cilësinë në

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

bazë dhe Kodit Zgjedhor e propozuesit, e ka marrë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Unë do të propozoja që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mos të na vijë me 3 variante po me 1 variant konkret që ai e gjykon të arsyeshëm që plotëson të gjithë kërkesat e Kodit Zgjedhor, faleminderit.

*Znj. I. Nano:* Faleminderit, zoti Çakaj. Nga ana ime nisur nga diskutimi pa hyrë në përmbajtjen e projektaktit, fillimisht në përgjigje të komentit që zoti Kaso bëri sigurisht që projektakti është vetëm lidhja, shtojca që i bashkëlidhet këtij vendimit kemi 3 variante por nuk i hymë kësaj në këtë moment. Kërkesa procedurale e zotit Salianji më bëri dhe mua t'i rishikoj në këtë moment bazën ligjore që i është referuar administrata e KQZ-së që ka propozuar këtë projektakt, nenin e kompetencës që është neni 20 dhe nenin autorizues që është neni 98 i ligjit. Në fakt, në zbatim të nenit 98, të pikës 1 të ligjit, ne kemi miratuar një vendim nr.6, 26 Shkurt "Për specifikimet teknike të fletës së votimit", kemi lënë të hapur mundësinë që të rishikojmë përmasën e fletës së votimit në varësi të listave shumemërore për zonat zgjedhore. Çështje kjo që u mbyll vetëm dje me vendimin e Kolegjit Zgjedhor, pra listat shumemërore u dorëzuan, u rishikuan, u kthyhen, u plotësuan dhe përfundimisht kemi një vendim të djeshëm të Kolegjit Zgjedhor. Është e natyrshme që ky projektakt është pavarësisht se kush e ka marrë iniciativën apo kush do të vendosë sigurisht vetëm pas ditës së djeshme mundet të shqyrtojë dhe të miratojë. Ndërkohë nëse në nenin 98, pika 1, përcaktohet në mënyrë të shprehur që specifikimet teknike miratohen me akt normativ të KQZ-së. Kur vëmë te pika 4, te paragrafi 4 i cili në fakt flet për atë çfarë përmban fleta e votimit, hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëqyes, mënyrën e votimit parapëlqyes, kushtin që informacioni të jetë i përcjellë nga fletët e votimit të mos jetë i ngarkuar e të tjera. Të gjitha këto përcaktohen nga KQZ-ja thotë ligji dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejt nuk ia ngarkon këtë Komisionit Rregullator. Pra, nëse në

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

dispozitat e tjera të Kodit shprehimisht, ai shprehet ose thotë: miratohet me akt normativ nga KQZ-ja, ose nga Komisioni Rregullator, këtu thuhet vetëm përcaktohet nga KQZ-ja. Po t'i referohemi nenit 19, ku janë kompetencat e Rregullatorit. Paragrafi 1, germa "n", te nenit 19, Komisioneri ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen KQZ-së me ligje të veçanta si dhe çdo kompetencë që ky ligji nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it. Po, zoti Çaka!

**Z. D. Çaka:** Edhe të përfaqësuesit dhe më pas të.. (*nuk kuptohet*) nëse do të vendosni për procedurën..

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Çaka! Po, zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit, zonja Kryetare. Ashtu si ky komision është në dijeni, ne jemi në limitet e fundit të realizimit të një procesi. Është shumë e rëndësishme që të avancojmë dhe sot duhet të ishte miratuar të themi me një propozim të qartë të Komisionerit fleta e votimit. Propozimi i bërë nga përfaqësuesi i subjektit politik Partia Socialiste më duket alogjik, se është eksplicite në ligj dhe në qoftë se do të ishte kështu, nuk do të ishte kështu në këtë rast ishte gjithë kohën e mjaftueshme për të bërë kundërshtimet e tij. Ashtu si komisioni kishte të gjithë kohën e mjaftueshme në qoftë se kishte parë një kompetencë të vetë ose moskompetencë, lidhur me bazën ligjore dhe me aktin e sjellë nga Komisioneri për të informuar Komisionerin lidhur me papajtueshmërinë ose mos kompetencën e vetë. Më duket një cenim propozimi i bërë nga përfaqësuesi. Një cënim i procesit në vetvete duhet të jemi shumë të kujdesshëm se koha është në limitet e saj.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Znj. I. Nano:** Për transparencë dhe të gjithë atyre që na ndjekin, ky akt është paraqitur zyrtarisht pranë Komisionit Rregullator ditën e djeshme. Siç ju thashë nuk mundet ky akt nga cilido organ që të miratohet të paraqitet para se merret vendimi i Kolegjit Zgjedhor për listat shumëmemërore. Sipas Rregullores, zoti Çakaj e përmendi me vend pak më herët. Detyrimi ynë si komision dhe i imi si Kryetare është të mbledhë komisionin brenda 24 orëve, sepse jemi në perjudhë zgjedhore. Ky është momenti që po e diskutojmë, pra nuk është një moment që mund ta kishim diskutuar dhe ju i ndiqni të gjitha mbledhjet tona. Nuk është diskutuar më herët, veprimtaria jonë zhvillohet në mbledhje publike. Kështu që thjesht për transparencë këtë po e theksoj, momentin e dërgimit zyrtar të projekaktit dhe momentin e mbledhjes, jemi mbledhur brenda 24 orëve.

**Z. M. Çakaj:** Subjektet zgjedhore në respekt të nenit përkatës të Rregullores që kemi miratuar ne të 5-të, do të thotë që subjektet zgjedhore kanë pasur 24 orë kohë për të paraqitur, depozituar kërkesa për më tepër të karakterit formal siç janë kompetencat.

**Znj. I. Nano:** Pra kemi zhvilluar jo pak mbledhje dhe deri tani asnjë subjekt zgjedhor nuk ka paraqitur asnjë herë kërkesë me shkrim ose kërkesa, ose propozime me shkrim. Kështu që edhe kjo i bie në të njëjtën praktikë që është ndjekur pra nuk është detyrim.

**Z. M. Çakaj:** Kjo nuk do të thotë që ia kemi hequr të drejtën. Unë vlerësoj që subjektet zgjedhore ose nuk kanë pasur interes për çështjen, ose nuk kanë pasur paqartësi.

**Znj. I. Nano:** Do të ishte një paragjykim të interesit të secilit nga ne që bëjmë një diskutim të caktuar.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Z. M. Çakaj:** Më fal mos të diskutojmë me supozime, por të diskutojmë me fakte reale. Nga dita e djeshme që të gjithë ne e pranojmë që është nisur zyrtarisht akti, deri në ditën e sotme ka propozime, paqartësi shtesa, vërejtje sugjerime mbi këtë akt? Nuk kemi.

**Znj. I. Nano:** Zyrtarisht me shkrim nuk na kanë ardhur në dosjen tonë. Dhe unë kam pyetje, në të gjitha mbledhjet që ka organizuar Komisioni Rregullator deri tani, ka pasur ndonjë rast që një subjekt zgjedhor edhe kur kemi pasur kohë më tepër të mjaftueshme 48 orë...

**Z. M. Çakaj:** Ta japë përgjigjen administrata. Unë diskutoj mbi çfarë kam këtu në tryezë.

**Znj. I. Nano:** Të gjithë të tjerët si anëtarë të Komisionit Rregullator e kemi pasur dosjen..

**Z. M. Çakaj:** Nuk ka akt më të rëndësishëm se ky. Të diskutosh mbi kompetencën vendore të këtij komisioni, ndërkohë që në gjykimin tim personal po besoj dhe e ndaj dhe kolegët këtë. Neni 20, pika 1, germa "a", e parashikon qartë se çfarë kompetence ka Rregullatori. Në nenin 98 që cituat ju, pika 1 parashikon në mënyrë të qartë sesi miratohet fleta e votimit, përfshirë dhe elementet teknik përfshirë dhe aktin e mëparshëm që kemi miratuar ne. Kështu që në këtë pikë në gjykimin tim kjo është e ezauruar. Nëse Komisioneri kërkon të marrë kohë të miratojë një model siç e gjykon ai, unë jam dakord t'i japim kohë.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Tani në lidhje me atë çfarë tha përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim, për sa i përket vonesës që mund të krijohet nga kërkesa që unë bëra këtu në seancë. Jam dakord me arsyetimin që tha përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim. Nuk bie dakord me atë çfarë tha zoti Muharrem Çakaj që ne duhet ta bëjmë me shkrim. Nuk e di sa është e formalizuar me rregulloren dhe me ligjin, ne kemi të drejtë të flasim në momentin që shqyrtohet, për të nxjerrë aktin për procedurë. Deri në moment që nuk është hapur mbledhja ne nuk kemi të drejtë ta ngremë këtë pretendim. Përsa u përket kompetencës dhe shpejtësisë, po fleta e votimit është akti më i rëndësishëm i këtyre zgjedhjeve. Pra, ne miratojmë çdo rregull, çdo ligj pse që të miratohet fleta e votimit. Unë po them një gjë shumë të thjeshtë, kjo është kompetencë e Komisionerit, ju duhet të çoheni që aty, ne vazhdojmë mbledhjen tani dhe ulet Komisioneri miraton fletën pra sot. Unë nuk them të shtyjë, të vijë Komisioneri siç po kërkon ju shtyerje nuk e di pse po kërkon këto shtyerje. Unë po them të vazhdojë mbledhja, të miratohet fleta tani, në këtë tavolinë mos të bëjmë debate. Por sipas nenit 20 sipas Kodit Zgjedhor kompetencë për ta shqyrtuar këtë projektakt është Komisioneri dhe ne vazhdojmë mbledhjen nga ky moment deri sa ne të miratojmë fletën.

**Znj. H. Vukaj:** Në qoftë se partitë e rreshtuara aty kanë marrë cilësinë e ndonjë organi të KQZ-së dhe shpërbërja e KQZ-së, na e thoni tani dhe po kërkojmë më pas të çbëhet KQZ-ja ose të bëhet nga e para.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Vukaj, për procedurë unë ua dhashë fjalën më herët të gjithë përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore. Deri tani zonja Bushati ka kërkuar disa herë fjalën. Po zonja Bushati.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së:** Faleminderit, atëherë debati mesa duket edhe po të rrimë disa orë mund të vazhdojë në drejtimin e kompetencës. Unë mendoj që rregulli e kërkon që ne nuk kemi pse dëgjojmë debatet brenda anëtarëve të Rregullatorit. Merrni një vendim mbi kërkesën nëse e keni kompetencë apo jo kush subjekt është i interesuar le të ankohet mbi vendimin tuaj të ndërmjetëm dhe pastaj vazhdojmë. Nuk ka pse as shtyhet nesër, ne dalim pak jashtë, ju merrni vendimin. Miratohet, nuk miratohet dhe vazhdohet.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Bushati për sugjerimin. Gjithsesi Komisioni Rregullator mbledhjet publike i zhvillon dhe në mbledhje publike marrin pjesë dhe përfaqësuesit e subjekte zgjedhore. Po zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Në vijim të procesit që është ndjekur do të doja të bëja me dije dhe publikut që vërtet ky akt ka ardhur pas vendimit të Kolegjit Zgjedhor. Vërtet ky akt ka ardhur 24 orë përpara. Por ky akt ka ardhur koshient dhe me vlerësimin maksimal juridik se kujt i takon kompetenca.

**Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI**





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Znj. H. Vukaj:** Pra, propozuesi është koshient dhe i vetëdijshëm që kompetenca është e organit Komisioni Rregullator. Ky akt është vijëmsi e aktit të miratuar më parë. Në atë akt kemi lënë përmasat e fletës bosh, kemi lënë dhe detaje të tjera të cilat lidhen në atë akt përmes shtojcës 1 dhe për këtë ne jemi të vetëdijshëm dhe e dimë shumë mirë që kjo do vinte me një plotësim të një akti të 2-të. Këtë mund t'ja bëjmë transparent publikut por njëkohësisht mund t'ja rikujtojmë edhe partive politike. Nëqoftëse zoti Komisioner di të mari kohën e duhur për të ndarë në propozimin e tij se cila është fleta, kjo do të lehtësonte të gjitha palët dhe në të njëjtën kohë do të na bënte të mos harxhonim asnjë minutë në kurriz të këtij akti kaq të rëndësishëm.

**Znj. I. Nano:** Për saktësi në datën 26 shkurt me vendimin nr.6 ne kemi miratuar specifikime teknike të fletës për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill dhe në këtë vendim pika 1, janë miratime të specifikimeve teknike sipas lidhjes, lloji letrës dimensionet specifikime të përgjithshme kemi miratuar dhe mundësinë që Komisioni Rregullator të ndryshojë përmasat e fletës së votimit në varësi të listave shumemërore.

**Znj. H. Vukaj:** Jo, zonja Nano nuk jeni transparente në këtë rast duhet të jesh e drejtë.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Kush i miraton fontet, karakteret, logot?

**Znj. I. Nano:** I miraton Komisioni Rregullator. Ju lutem bëni kujdes në fjalorin që përdorni me njëri tjetrin, fjalën e miratoj me hile nuk e pranoj. Ky është vendimi, ky është projektvendimi.

**Znj. H. Vukaj:** Për replikë, po ju them bëjeni transparent për publikun.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Znj. I. Nano:** Ju lutem, publiku mund të gjejë vendimin nr.6 datë 26.02.2020. të gjithë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore mund të jenë dhe janë të njohur më këtë vendim.

**Znj. H. Vukaj:** Dakord, për publikun po nxjerrim dhe aktet që ne i kemi punuar midis njëri-tjetrit për transparencë dhe kemi thënë për publikun që të gjitha të tjerat e lëna bosh do përmbusheshin përmes këtij akti që janë fonti, madhësia e shkrimit, pozicionet e emrave apo logove e kështu me rradhë.

**Znj. I. Nano:** Zoti Kaso, ju lutem.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zonja Kryetare, shoh që debati po degjeneron në kuptimin juridik të diskutimit, diskutimi i themelit me diskutimin e kërkesave paraprake ose të atyre që u ngritën në thonjëza për procedurë. Për procedurë duhet të përcaktohet rregulli për shqyrtimin e aktit. Nëqoftëse ne diskutojmë për brendësinë e aktit, siç diskutojë kolegu i nderuar që thotë është kompetenca juaj s'është kompetenca juaj, jo e ka neni 20 jo e ka neni 21. Nëqoftëse ju zonja Kryetare sikur morët fjalën, diskutuat sepse lexuat edhe ju përmbajtjen e aktit dhe të bazës ligjore dhe dhatë arsyetimin tuat të drejtë apo jo që është kompetenca juaj, që diskutojmë përmbajtjen e aktit. Kërkesa ime është kërkesë mbi çfarë akti do diskutojmë dhe çfarë aneksi ka? Në momentin që unë kërkoj t'i kthehet Komisionerit për saktësim në momentin që ka një kërkesë nga një kolegja juaj që t'i kthehet Komisionerit për saktësim për të parë mbi çfarë akti do diskutojmë. Ne nuk mund në asnjë mënyrë të diskutojmë faktin çfarë baze ligjore ka, as faktin ka një akt tjetër që i lë të përcaktojë disa gjëra apo jo, sepse ne flasim për kërkesat që duhet të ngrihen përpara dhe të trajtohen përpara se të futemi në brendësi. Ju pa u shprehur për ato kërkesa dilni diskutoni themelin. Nëqoftëse dilni diskutoni themelin e kam dhe unë një mendim timin



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

po nuk është ky momenti për ta diskutuar. Atëherë kemi dy kërkesa një kërkesë për shtyrje nga kolegu juaj që thotë nuk kam patur kohë të njihemi me këtë kërkesë paraprakisht dhe më duhet kohë të formulojë arsyetimin paraprakisht dhe kemi një kërkesë nga unë nëqoftëse kuptova drejt një kolegja juaj thotë që akti duhet të saktësohet dhe mbasi ta kemi aktin hajde diskutojmë gjithë ditën e gjithë natën, përcakton rregulla e ka komisioneri apo e keni ju? E ka akti përpara tagrin që ju të miratoni gjera të tjera me këtë akt apo i ka mbyllur të gjitha ai akti i mëparshëm? Ta orientojmë pak në mënyrë produktive diskutimin pasi një orë kalojë për efete teknike për t'u lidhur me të gjithë pjesëmarrësit, një orë me diskutime për të hedhur në shqyrtim kërkesat. Unë kerkojë formalisht të hidhen në votë kërkesat që kemi ngritur para se të kalojmë tek brendësia e aktit dhe nëqoftëse dy kërkesa rrëzohen, hajde të kalojmë tek brendësia e aktit. Merrni ju fjalën të marrim ne fjalën, të themi e keni apo jo kompetencë. Faleminderit.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zoti Kaso. Përpara se të kalojmë tek përmbajtja e aktit, unë mendoj se më së pari duhet diskutuar kërkesa për faktin nëse është kompetencë ose jo e Rregullatorit. Nëse vlerësohet që nuk është kompetencë e Rregullatorit, a ka logjikë që të vijojmë me përmbajtjen? I nderuar ju lutem mund të prezantoheni. Zoti Shabani mund t'i lejmë radhën anëtarit të komisionit pastaj ju. Po, zoti Çaka.

**Z. D. Çaka:** Në pamundësi për të qenë dhe unë prezent mendoj që është e vërtetë ajo që tha zoti Çakaj, ku në rregullore është përcaktuar që çdo subjekt politik përpara zgjedhjes mund të paraqesi mendimet e tij, kërkesat e tij për ndryshime. Nuk ja kemi hequr të drejtën askujt për ta bërë publike në seanca. Unë mendoj që çdo kërkesë e çdo subjekti politik duhet vlerësuar në seancë dhe është i pa rëndësishëm fakti nëse e ka bërë me shkrim ose jo në protokoll. Së

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

dyti jam dakord me faktin që mund të këtë dhe kërkesa të tjera dhe jam dakord si dhe dy kolegët u shprehën më parë. Për arsye shëndetësore nuk kam qenë prezent pranë jush dhe po e riformulojë kërkesën time që Komisioni të mari kohë për t'a diskutuar këtë çështje, unë mendoj që është çështje parësore pastaj hyjnë çështje të tjera pa shqyrtuar në rradhë të parë kompetencën tonë. Prandaj dhe njëherë kërkojë kohë. Fakti që ka nga komisioneri një kërkesë ose nga ne, duhet të reflektojmë dhe të dëgjojmë çdo kërkesë dhe të ndryshojmë mendimin tonë nuk ka ndonjë gjë, është shumë pozitive.

*Znj. I. Nano:* Faleminderit zoti Çaka. Zoti Shabani, po.

*Z. E. Shabani, përfaqësues i Partisë Nisma Thurrje:* Përshëndetje, jam zoti Shabani dhe vi nga Nisma Thurrje. Doja të jepja mendimin tim në lidhje me dy çështjet që u diskutuan. E para në lidhje me kompetencën Kodi Zgjedhor është shumë i qartë që neni 98 pika 4 thotë që KQZ-ja përcakton mënyrën e votimit parapëlqyes dhe kjo është një rregullim i mënyrës se si votuesi shpreh vullnetin e tij në zgjedhje, nëqoftëse Rregullatori nuk vendos këtë unë nuk kuptoj pse ekziston Rregullatori. Këtu nuk po flasim për detaje teknike po flaim për krijim e kushteve për zbatimin e një të drejte kushtetuese që ka votuesi dhe për të shprehur vullnetin e tij. Kodi Zgjedhor vazhdon duke thënë: që sido qoftë mënyra duhet bërë në një mënyrë të tillë që zgjedhësi ta këtë të lehtë orientimin për të shprehur vullnetin e tij në zgjedhje dhe këtu pa dashur të hyjmë në detaje që mund ta bejmë më vonë diskutimin. Këtu rregullat duhet të jenë në mënyrë të tillë që t'i jepet mundësi votuesit të shprehë qartasi vullneti i tij. Ndërkohë kemi raste të shteteve fqinj si Kosova të cilët kanë përdorur disa molele që kanë rritur numrin e pavlefshmërisë së votave. Për të hyrë shumë shkurt në përmbajtje kemi një KQZ të re, kemi një strukturë të re, kemi një kohë jashtëzakonisht të shkurtër përpara dhe unë nuk besoj se KQZ-ja ka ndonjë

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

shqetësim më të madh sesa fakti që këto zgjedhje të mos kenë një numër të jashtëzakonshëm fletash të pavlefshme dhe këto zgjidhen përmes rregullave të cilat evitojnë votat e pavlefshme dhe i krijojnë mundësi votuesit që të shpreh vullnetin e tij gjë të cilët KQZ-ja dhe dua ta përgëzojë për një hap të tillë KQZ-ja ka pyetur votuesit. Jam i sigurt që ju keni negociuar me partitë, por këto zgjedhje nuk janë për partitë janë për votuesit. Është pyetur votuesi 11500 vota ka shprehur qartazi që unë e kuptoj thotë votuesi këtë fletë votimi, 79% përballë një flete tjetër. Tani votuesi i cili është arsyeja pse ne të gjithë jemi mbledhur këtu, arsyeja pse kemi një sistem zgjedhor, ka shprehur qartë një model. Tani të dalim në teknalitete për të penguar votuesin që të shpreh të drejtën e tij kushtetuese për të zgjedhur. Besoj se dalim përtej tagrit që ky institucion ekziston dhe jemi mbledhur. Pa dashur të zgjatem më tej, faleminderit për fjalën.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zoti Shabani. Pyetjes tuaj se përse duhet të ekzistojë Rregullatori do i thoja t'i riktheheshit veprimtarisë së Rregullatorit në kohën kur partia juaj nuk ishte regjistruar si subjekt zgjedhor dhe ky Komision Rregullator dhe kjo KQZ me 3 organe ka nxjerr me dhjetra vendime, ka trajtuar me dhjetra çështje dhe ky është një ndër vendimet shumë të rëndësishëm pa diskutim. Nuk jemi duke diskutuar të drejtën kushtetuese të zgjedhësve sepse këtë nuk besoj se i shkon në mend njeriu që t'ja mohojë nëpërmjet marrjes së një vendimi ose mos marrjes. Jemi duke diskutuar kompetencën kush do marri këtë vendim pra që ne vendosim do të merret lidhur me përmbajtjen e fletës së votimit, nuk besoj se e vë njeri në dyshim. Me numra, me emra të përzier nuk i kemi hyrë ende kësaj çështje. Gjithsesi, Komisioner ju lutem sepse keni kërkuar fjalën më herët. Faleminderit.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Z. I. Celibashi:** Po faleminderit, zonja Kryetare unë do të propozoja dhe në vijim të asaj çfarë thashë në relativitet të projektakteve të paraqitura nga ana ime, por konsideruar edhe diskutimet e kolegëve, anëtar të Rregullatorit por dhe përfaqësues të partive politike, meqënëse në mënyrë eksplicite u theksua se do të ishte më e dobishme për diskutimin nuk po i hyj fare çështjes së kompetencës sepse e kam shprehur por duke qenë se akti që unë kam propozuar për t'u shqyrtuar nga ana e Rregullatorit nuk është i finalizuar në pikëpamje dhe të asaj se si në vlerësimin e Komisionerit, asaj se si do të jetë përmbajtja e fletës së votimit e gjej me vend atë çfarë tha përfaqësuesi i Partisë Demokratike. Le ta marrim kohën për ta formalizuar aktin me të gjitha ekstremitetet e veta dhe pastaj mund t'a bëni këtë debatin e kompetencës pasi të keni aktin nëse është kështu ajo çfarë u diskutua nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike dhe unë do ta risjell aktin me një propozim konkret sesi Komisioneri e propozon përmbajtjen e fletës së votimit. Pastaj është çështja juaj nëse doni ta shqyrtoni, nëse e konsideroni kompetencën tuaj, apo nëse e konsideroni kompetencën tuaj do ta pranoni atë propozimin e Komisionerit? Faleminderit.

**Znj. I. Nano:** Pyetja ime është: A e tërhiqni këtë aktin me iden për të sjell një akt tjetër?

**Z. I. Celibashi:** Po, me idenë për t'a plotësuar këtë akt në mënyrë përfundimtare, me një propozim konkret sesi do të jetë përmbajtja e fletës së votimit.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Meqënëse ka një propozim, kam bërë dhe unë një propozim dhe mos hamë kohën, nëqoftëse ju, në lidhje me propozimin që bëri Komisioneri unë jam dakord që ju ta pranoni propozimin, por pa diskutuar në këtë moment kompetencën. Pra nëqoftëse mbledhja e ditës së nesërme do të jetë në të njëjtën fazë diskutimi!

**Znj. I. Nano:** Atëherë ne duhet ta mbyllim mbledhjen se nuk kemi akt në këtë moment!

**Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Po mund të mbyllet mbledhja,

**Z. M. Çakaj:** Unë nuk jam fare dakord me këtë, absolutisht jo! Atëherë meqë përfaqësuesi i subjektit zgjedhor të Partisë Socialiste, bëri një propozim konkret, unë jam dakord që në bazë dhe të rregullores tonë ne ta votojmë. Neni 20 i Kodit Zgjedhor, parashikon në mënyrë të qartë vendimet e Komisionit Rregullator, parashikon në mënyrë të qartë kuorumin për secilin vendim, kështu që unë propozoj që ta votojmë këtu kompetencën. Në rast se Komisioneri do tërhiqet për të ri propozuar aktin, atëherë sigurisht që është e tejkaluar kjo pikë, por kjo çështje fillon dhe mbyllet këtu, nuk ka më diskutime, ri nisim përsëri me çështje kompetence. Në gjykimin tim personal, Kodi Zgjedhor e parashikon në mënyrë të qartë kompetencat e Rregullatorit. Tani kjo është humbje kohe për të gjithë shqiptarët, sigurisht që çdo minutë është e çmuar. Kompetenca meqë u shtrua, u propozua, u ngrit si pretendim nga përfaqësuesi i subjektit zgjedhor të Partisë Socialiste, të hidhet në votim, nëse merr kuorumin e nevojshëm të parashikuar nga Kodi, le të rrëzohet ky akt, ta marri kompetencën Komisioneri, nëse nuk e merr atëherë vijon kompetenca këtu.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Znj. I. Nano:** Jo çështja e kompetencës, nëse do vijojë, nuk është, rrëzohet akti dhe e merr Komisioneri.

**Z. M. Çakaj:** Rrëzohet propozimi jo rrëzohet akti, rrëzohet propozimi, kemi një propozim i cili kërkon kuorumin e caktuar,

**Znj. I. Nano:** Komisioneri e tërhoqi në këtë moment, aktin për të sjellë një akt të ri,

**Z. M. Çakaj:** Jo nuk e ka tërhequr. Jo, ne ndajmë tani e nderuar kryetare, ne e ndajmë tani kompetencën, e kemi apo s'e kemi. Nëse ju keni votat e mjaftueshme dhe të nevojshme të parashikuara nga neni 20 i Kodit Zgjedhor, e heqim për kompetencën e Rregullatorit dhe le ta gjykojë vetë Komisioneri në përputhje me Kodin Zgjedhor, përkundrazi fillon këtu dhe mbyllet këtu çështja e kompetencës, ne vijomë me shqyrtimin e themelit të aktit.

**Znj. I. Nano:** Z. Çaka, të lutem meqënëse është on line,

**Z. D. Çaka:** Në rradhë të parë unë e kam kërkuar me kohë që në fillim, për ta shqyrtuar atë kërkesën që bëri përfaqësuesi i partisë politike, ama dhe kjo që, për mendimin tim nuk mundet të vazhdojë, sepse nëqoftëse,

**Z. M. Çakaj:** Atëherë më fal se po ju pres fjalën, atëherë tërhiqet subjekti zgjedhor nga propozimi? Jo, jo tërhiqet subjekti zgjedhor nga propozimi, nëse tërhiqet nuk e hedhim në votim. Nëse ka, qëndron,

**Z. D. Çaka:** U tërhoq Komisioneri,





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Z. M. Çakaj:** Jo jo nuk u tërhoq Komisioneri, propozoi Komisioneri, ktheje audion.

**Z. D. Çaka:** Komisioneri u tërhoq nga propozimi,

**Z. M. Çakaj:** Z. Çaka, Komisioneri, propozoi, e kemi audio të regjistruar dhe nuk diskutohet, propozoi,

**Znj. I. Nano:** Tani, atëherë zoti Çaka, të lutem, një anëtare e Komisionit Rregullator,

**Z. D. Çaka:** Po kur të mbaroj, mora fjalën!

**Znj. I. Nano:** Po zoti Çaka, po!

**Z. D. Çaka:** Nuk i hyra askujt, mora fjalën time!

**Znj. I. Nano:** Po!

**Z. D. Çaka:** Atëherë nëqoftëse ju mendoni që, për kompetencën, hajde votojmë për të 3 fletët e votimit që ka propozuar Komisioneri por jo për të zgjedhur ne. Komisioneri ka zgjedhur 3.

**Znj. I. Nano:** Z. Çaka,

**Z. D. Çaka:** Hajde i votojmë të treja fletët e votimit,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Znj. I. Nano:** Z. Çaka, para se të shkojmë tek votimi,

**Z. D. Çaka:** Unë kërkoj kohë, që të gjithë të shqyrtojmë të gjitha kërkesat që po bëhen, si nga partitë politike, si nga Komisioneri, nëqoftëse çështja është hajde bëjmë këtë dhe nuk bëjmë këtë, nuk besoj se çështja është me presionet bllokuese.

**Znj. I. Nano:** Jo Z. Çaka, të lutem,

**Z. D. Çaka:** Edhe njëherë kërkoj kohë,

**Znj. I. Nano:** Atëherë, për procedurë, u bënë shumë diskutime, një pjesë lidheshin me kompetencën, një pjesë lidheshin me aktin në vetvete. Si zonja Vukaj si anëtare e Komisionit Rregullator dhe zoti Kaso si përfaqësues i subjektit zgjedhor Partia Demokratike, apo është përfaqësues i koalicionit, në dijeninë time përfaqësues i Partisë Demokratike, thamë nuk kemi akt, po i koalicionit, ndjesë, nuk kemi akt tha zoti, të lutem nuk kemi akt pra,

**Znj. H. Vukaj:** E bëj unë saktësimin,

**Znj. I. Nano:** Nëse nuk kemi akt tha zoti Kaso, nuk mund t'i hyjmë diskutimit për kompetencën, në këtë moment Komisioneri, pra akt do të votosh pro ose kundër një akti, ndërkohë që kemi 3 fletë.

**Znj. H. Vukaj:** Akt përfundimtar, nuk mund të sjellësh 3 fleta, 3 formate llojesh fleta votimi, në momentin kur të treja për mua përbëjnë akt më vete, janë 3



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

shprehje të ndryshme vullneti, kështu që në këtë moment unë dhe zoti Kaso mesa kuptova kërkua të njëjtën gjë, pra marrjen kohë nga ana e Komisionerit që të përzgjedhim një vullnet të vetëm.

**Znj. I. Nano:** Dhe Komisioneri tërhoqi këtë akt me 3 fletë, me 3 variante,

**Z. M. Çakaj:** Komisioneri propozoi e nderuar,


**Znj. E . Bushati, përfaqësuese e LN-së:** Të lutem, atëherë të lutem a mund të, jo jo një sekondë se kjo që po bëhet këtu, kjo s'është fare transparente, as nga ana e Rregullatorit,

**Znj. I. Nano:** Po më transparente se kaq s'ka ku të vejë,

**Znj. E . Bushati, përfaqësuese e LN-së:** Jo, s'është fare transparente as nga ana e Komisionerit dhe kjo le vend edhe për hamendësime të tjera, por kjo është temë tjetër. Këtu ka një propozim, askush nuk e ndalon Rregullatorin, përveç çështjes së kompetencës që unë mëshoj që përderisa është bërë duhet të ketë një vendim nga ana juaj por ju as këtë nuk keni vullnetin për ta bërë.

**Znj. I. Nano:** Atëherë propozimi juaj është,

**Znj. E . Bushati, përfaqësuese e LN-së:** Një sekondë ta mbaroj. Tani këtu ka, Komisioneri ka bërë një propozim dhe ka thënë po vij me këto, hajde duhet diskutuar cili propozim është më i miri sipas mendimit tonë si subjekte zgjedhore dhe pastaj të vendosni ju, se ç'kuptim ka që Komisioneri të propozojë një fletë votimi dhe ju ta votoni, ai shumë mirë propozimi j'u ka ardh 3



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

alternativa, ç'kuptim ka nëse ai e tërheq këtë me 3 dhe ju paraqet 1. Çfarë do diskutoni nëqoftëse ka 1 dhe ju lutem shumë përmbahuni rregullave proceduriale. Ka një këkesë për kompetencë, e keni, s'e keni, tani këto lojërat me sms që prit se unë kërkoj kohë, prit ta diskutojmë kështu, unë tërheq propozimin kjo vetëm hedh hije dyshimi mbi vendime që nuk merren në këto salla por që merren në vende të tjera. Faleminderit!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** E nderuar zonja kryetare nëqoftëse mundem?

**Znj. I. Nano:** Patjetër z. Kaziaj! Zonja Bushati edhe njëherë të lutem juve edhe gjithë pjesëmarrësve në këtë mbledhje. Kemi disa muaj që zhvillojmë mbledhje të Komisionit Rregullator, më e pakta kemi ruajtur një komunikim etik me njëri-tjetrin, me të gjithë. Do doja të vijonim. Unë personalisht do të vijoj! Këtë do ta kërkoja edhe nga të tjerët. Zoti Kaziaj po, faleminderit!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** E nderuar zonja kryetare, po shohim që, sot për herë të parë Komisioni Rregullator po mban një qëndrim të themi, të dyfishtë, merren propozimet e një subjekti politik dhe nuk hidhen në votim, merren propozimet e anëtarëve të Komisionit Rregullator dhe pa u hedhur në votim pranohen, tani ju lutem shumë! Një anëtar i Komisionit Rregullator, bëri një propozim lidhur me marrjen në shqyrtim e kërkesës së bërë nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë, pse nuk merret kjo kërkesë në shqyrtim nga ana juaj? Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Si drejtuese e kësaj mbledhje dëgjova dhe propozime të tjera, sepse kanë lidhje me njëra-tjetrën.

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Patjetër, i marrim të gjitha në shqyrtim.


**Znj. I. Nano:** Dhe më së fundi dëgjova dhe Komisionerin që është ai që ka vënë në lëvizje Komisionin Regullator, sipas Kodit Zgjedhor, prandaj personalisht nuk e di kolegët, personalisht jam që dhe kjo s'mund ta hedhim në votë, të pranojmë kërkesën, është për mua s'ka nevojë për votim ajo që Komisioneri tha që të tërheqi këtë projektakt, i cili,

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Kërkesa e Komisionerit për tërheqjen e projektaktit ka qenë e mëvonshme ndërkohë që kërkesat i kanë paraprirë, kërkesat e tjera. Të lutem të merren kërkesat dhe pastaj, Komisioneri është vetëm përpilues i aktit dhe e ka sjellë përpara këtij Komisioni, si Komisioni kompetent për shqyrtimin e këtij akti.

**Znj. I. Nano:** Po, është propozuesi i aktit dhe mundet t'a tërheqi në çdo kohë propozimin, kështu që,

**Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së:** Më falni, nëqoftëse nuk vendoset për kompetencën pse duhet mbase ju vendosni që nuk e keni kompetencë, atëherë nuk ka pse të vihet në lëvizje edhe njëherë Komisioneri, t'ju bëjë një propozim etj, mund t'a vendosni që e keni atëherë po, pra kjo e ndan këtë punë, atëherë pse duhet që ju sot të mos e merrni këtë vendim për kompetencën?

**Znj. I. Nano:** Në fakt këtë pyetje zonja Bushati do t'ja drejtoja gjithë folësve në këtë mbledhje pasi foli zoti Salianji, pasi bëri propozimin dhe kërkesën,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së:** Më falni, debatet kur ka kërkesa paraprake në çdo procedurë është kështu, ai po të hedh poshtë kompetencën, çfarë do të thotë, që në të gjithë gjykatat e botës, në të gjithë trupat administrativë dhe gjyqësore të botës, vendoset njëherë e kam nuk e kam, pastaj vendoset nëse e ke vazhdohet dhe zoti Celibashi pasi që të vendosi kompetenca juaj mund të vendoste të thoshte jo po të sjell 3 jo mund të sjell 5 propozim, 1 propozim apo mund të vendosim më tutje. Ku është parë që këtu flitet a e keni kompetencën dhe trupa thotë jo prit se do ta mendoj njëherë. Ajo nuk ka, ajo është sot data 30 mars dhe nëse një parti politike, unë po të kisha qenë në vendin e kolegut të PS-së edhe për faktin që ju s'po merrni vendim sot do e kisha ankimuar në Kolegjin Zgjedhor, sepse për çështjen e kompetencës mund të ketë dhe rrugë ankimi, një subjekt zgjedhor mund të ushtrojë dhe të drejtën e ankimit, që do hajë një short, 1 ditë, 2, 3 ditë në Kolegjin Zgjedhor, ndërkohë që ne po rrimë këtu edhe përtej orës të përcaktuar, për të mos bërë asgjë sot, pse. Sepse partitë e mëdha kanë debat nëse e duan variantin 1, 2 apo 3, dhe Regullatori thotë nuk ma mban të marr vendim dhe Komisioneri thotë prit të tërhiqem edhe njëherë të shoh partitë e mëdha.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Bushati edhe njëherë, që bëtë analizën, arritët dhe në përfundimet sesi është situata.

**Z. D. Çaka:** Përfaqësuesja e partisë politike mos bëj akuza ndaj asnjërit dhe unë i kërkoj vëmendje, në rregull, si unë dhe si të 4 ju që po kërkojmë kohë për të shqyrtuar një kërkesë, ndaj ju lutem shumë respektoni etikën!

**Znj. I. Nano:** Zonja Bushati e dhatë mendimin tuaj. Po zoti Kaso!



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zonja kryetare, është hera e fundit që flas, për të shprehur mendimin tim për këtë çështje, më pas do t'ju a lë juve. U ri hap edhe njëherë çështja, pasi Komisioneri bëri një propozim konkret për të tërhequr aktin nëqoftëse duhet të shqyrtohet kompetenca apo jo. Nga këndvështrimi im akti që shqyrton sot Rregullatori nuk është akti juaj, të cilin ju e shqyrtoni apriori dhe është ose jo tagri juaj që të shpreheni mbi të, është akt i Komisionerit që ju shtron juve për propozim dhe më pas në varësi të aktit që ju sjell Komisioneri për propozim ju diskutoni që keni kompetencë apo jo të shqyrtoni atë akt. Në mënyrë paradoksale kot për absurd Komisioneri mund ta tërheqi aktin dhe t'ju sjellë një akt tjetër që qartazi nuk është në kompetencën tuaj ose qartazi është në kompetencën tuaj sepse mesa duket edhe këtu ka një farë debati është apo s'është kompetencë juaj, do t'ja jepni këtë mundësi Komisionerit që ju ka thirrur dhe më pas të gjykoni nga mënyra sesi do ta formatojë ai aktin, është përmbajtje, është rregull, është procedurë, është urdhër, është udhëzim apo çfarëdo lloj gjëje që të jetë pasi ta bëni dhe ju këtë diskutim apo nuk do ta bëni, kjo këkesë mendoj unë mund të shqyrtohet paralelisht edhe me kërkesën e kolegut tuaj i cili thotë nuk kam patur kohën dhe nuk jam përgatitur për t'a shqyrtuar sot një kërkesë të tillë. Marr për analogji atë që tha kolegja e nderuar në shqyrtimet gjyqësore, nëqoftëse paditësi investon gjykatën qoftë edhe të gabuar me një kërkesë padi, përpara se të shprehet gjykata ose avokati i palës tjetër për juridiksionin ose jo, apo për kompetencën ose jo, qoftë kjo dhe kërkesë paraprake, nëqoftëse paditësi në të njëjtin moment procedural me të njëjtën kërkesë paraprake e tërheq padinë, nuk kalon diskutimi nuk shprehet dot as avokati tjetër, as gjykata është apo jo kompetente ta shqyrtojë. Me të njëjtën analogji, nëse ju veproni me të njëjtat rregulla procedurale, të cilat ky Kod i referon te Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Administrative, kur nuk e detajon në mënyrë shteruese këtë moment, ju ftoj



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

edhe njëherë ju ri bëj kërkesë që, institucioni pjesa e të njëjtit institucion të cilët jeni edhe ju që ka marrë mundimin dhe ju ka vënë në lëvizje, të saktësojë aktin e tij dhe më pas së bashku me ne e thashë diskutojmë sa të doni, jeni apo jo kompetentë, e bëjmë apo s'e bëjmë këtë gjë! Faleminderit


**Znj. I. Nano:** Zoti Kaso ju falenderoj. Pak më herët të njëjtin mendim dhashë personalisht. Në momentin që Komisioneri e tërhoqi aktin, nuk kemi çfarë akti të shqyrtojmë, qoftë për kompetencë qoftë për përmbajtje. Pra në momentin që Komisioneri sjell një akt tjetër mund të gjykojmë mbi atë akt. Kolegë unë mendoj që,

**Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Se e zgjidh propozimin, se mendojmë të gjithë njësoj por pastaj kur shprehemi,

**Znj. I. Nano:** Nuk ka nevojë për votim, unë do të thoja shtyjmë seancën, sepse nuk mund të votojmë ta tërheqi apo jo Komisioneri aktin, është vullneti i tij. I nderuar Komisioner, qëndrimi juaj ju lutem lidhur me, e tërhiqni apo jo aktin?

**Znj. H. Vukaj:** Debati vazhdon, zonja Nano, për hir të mungesës së shprehisë nga ana e Komisionerit, kështu që lutemi zoti Komisioner të merrni një vullnet të shprehur se çfarë do të bëni në lidhje me aktin.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Po e sqaroj dhe njëherë ndoshta që aktin që kam paraqitur po e tërheq për ti bërë plotësimet dhe për ta sjellë në mënyrë definitive me një propozim konkret sesi do të jetë përmbajtja e fletës së votimit dhe padyshim kjo nuk e përjashton në pjesën përshkruese, arsyetuese të tij gjithë variantet dhe mundësitë që qoftë Komisioneri veçmas apo dhe në konsultim me





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.30.03.2021*

faktorë të tjerë, ka bërë për variante të ndryshme të përmbajtjes së fletës së votimit, por paraqitur në këtë mënyrë ose ri paraqitur në këtë mënyrë projektakti unë mendoj që do t'ju jap juve mundësinë për të bërë ndoshta dhe diskutimin e kompetencës ose aty do të kuptoni nëse ky akt, ashtu sikurse do të ri paraqitet dhe po flasim për një paraqitje jo më vonë se 24 orë nga dita, nga ky moment, ju ta vendosni ndoshta dhe në mënyrë përfundimtare.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Atëherë kolegë, mendoj që duhet ta mbyllim mbledhjen sepse nuk kemi për të shqyrtuar diçka tjetër, dhe çdo projektakt tjetër që vjen për shqyrtim në Komisionin Rregullator sipas rregullores do të thërrasim mbledhjen dhe do ta shqyrtojmë dhe me shpresë ta miratojmë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*

